



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Memorandum Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi

ndërmjet

**Organit Kombëtar të Investigimeve të
Aksidenteve/Incidenteve
Ajrore në Aviacionin Civil**

dhe

Njësia Transportit Mjeksor me Helikopter

**Lidhur me Bashkëpunimin dhe Mirëkuptimin në rastet
e Aksidenteve/Incidenteve në fushën e Aviacionit Civil.**

PËRMBAJTJA

1. Fjalori
2. Hyrje
3. Terminologjia
4. Qëllimi
5. Mirëkuptimi i ndërsjelltë dhe bashkëpunimi në rast Aksidenti dhe Incidenti.
6. Bashkëpunimi në fushën Teorike dhe Praktike për ngritjen e nivelit të Sigurisë.
7. Rolet dhe Detyrat e Palëve.
8. Principet bazë të B
9. Kontaktet

1. Fjalori (shpjeguesi i termave të përdurura)

AAC	Autoriteti i Aviacionit Civil
AC	Aviacioni Civil
TIA	Tirana International Airport
MB	Memorandum Bashkëpunimi
RSh	Republika e Shqipërisë
CVR	Cockpit Voice Recorder
OKIIA	Organi Kombëtar i Investigimit të Incidenteve/Aksidenteve
NJTMH	Njësia Transportit Mjekësor me Helikopter
HeL	Helikopter
FOD	Flight Operation Department
FCO	Flight Control Officer
SMH	Spektori Mirembajtjes se Helikoptereve
VQH	Vend Qendrim i Helikoptereve.
HELIPORT	Vend-Ngritje dhe Ulje për Helikopterët
VMC	Visual Flight Rule
VFR	Instrumental Flight Rule
IND	Investigator në Detyrë

2. Hyrje

2.1 Ky Memorandum Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi shpreh mirëkuptimin e OKIIA dhe të NJTMH, të cilave më pas do ti referohemi si Palët në këtë MB, lidhur me bashkëpunimin dhe asistencën në rastin e një Aksidenti/Incidenti të rëndë në fushën e Aviacionit Civil.


Palët i përgjigjen ligjeve të RSh-së dhe për këtë arsye ata janë të lidhur nga standardet e përfshira në këtë legjislacion :

- a) Ligji Nr.10040, datë 22.12.2008. Për “ Kodin Ajror” te RSh i ndryshuar.
- b) Ligji Nr.10233, datë 11.02.2010. Për “Aviacionin Civil” i ndryshuar.
- c) Vendimi i Këshillit te Ministrave Nr.68, datë 2.6.2010.Per krijimin e Organit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve /Incidenteve Ajrore në Aviacionin Civil.

2.2 Ky MB përcakton masat proceduriale për bashkëpunim dhe asistencë midis Palëve në përputhje me legjislacionin e mësipërm.

3. Terminologjia

3.1 Fjalët dhe frazat e përdorura në këtë dokument, kanë të njëjtin kuptim ashtu si përkruhet në legjislacionin e RSh.



4. Qëllimi


- 4.1 Memorandumi i Bashkëpunimit (më poshtë do të shkruhet MB) ka si qëllim që, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, kordinimin e veprimeve në hapsirën e ndodhjes së ngjarjes, dhënien nga NJTMH të dokumentave të ndryshme të fluturimit të HeL të aksidentuar ose me incident të rëndë, mbështetjen e palëve me specialistë ose expertë, për të kryer një investigim sa më objektiv në nxjerrjen e shkaqeve të aksidentit/incidentit të ndodhur.
- 4.2 Nëpërmjet këtij MB Palët synojnë të ndihmojnë OKIIA në kryerjen e një Investigimi të saktë e të shpejtë për nxjerrjen e shkaqeve të aksidentit/incidentit, me qëllimin parësor të parandlimit të tyre në të ardhmen.

5. Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi i ndërsjelltë

- 5.1 MB angazhon NJTMH në informimin sa më të shpejtë nëpërmjet FOD në rastin e ndodhjes së një aksidenti ose incidenti në rajonin e Heliportit dhe jashtë tij, ndodhur në destinacionet përkatëse brenda ose jashtë territorit të RSh.
- 5.2 Palët punojnë së bashku në përgatitjen dhe zbatimin e rekomandimeve të cilat i jepen operatorit (NJTMH) për parandalimin e aksidenteve e incidenteve në të ardhmen.
- 5.3 MB synon rritjen e efikasitetit në kryerjen e detyrës e të dy Palëve, në rast të një incidenti/aksidenti të rëndë ne:
 - d) Përmirësimin e sigurisë së fluturimit dhe gjatë lëvizjeve së HeL në tokë.
 - e) Përpikmërinë e kryerjes së mirëmbajtjes HeL në përputhje me kërkesat e rregulloreve dhe manualeve si dhe standartet e vendosura nga rregulloret e BE.
 - f) Përmirësimin e masave në raste Emergjencash si: ulje e detyruar brenda dhe jashtë Heliportit, në rast të zjarrit, në rast të evakuimit të pasagjerëve.
 - g) Në perfeksionimin e vazhdueshëm profesional të Ekuipazheve Fluturuese dhe atyre Teknike.
- 5.4 Nëpërmjet këtij MB, gjithashtu me kërkesën e OKIIA, NJTMH ndihmon me specialist pilotë e teknikë në kryerjen e investigimeve që OKIIA kryen.
- 5.5 NJTMH me kërkesë të IND të OKIIA ndihmon me mjete dhe paisje për çmontim pjesësh të HeL të aksidentuar dhe ruajtjen e tyre të përkohëshme.
- 5.6 NJTMH në rast të aksident/incidenti i siguron IND dokumente si me poshtë:
 - Listën e plotë të pasagjerëve të imbarkuar dhe dokumenta të tjera të tyre.
 - Fletën e balancës së peshave dhe të vendosjes së tyre në HeL të aksidentuar.
 - Fletën e shërbimeve të kryera në tokë përpara ngritjes.
 - Dokumentin e furnizimit me karburant.
 - Technical Log-Book (proçes-verbalet teknike).
 - Dokumentat personale të Ekuipazhit: Liçensat,Çertifikatat shëndetsore si dhe dokumentin personal të identifikimit.
- 5.7 Kryerja e investigimit nga ana e OKIIA nuk ka p' er qëllim përcaktimin e përgjegjësisë apo të fajit.
- 5.8 OKIIA dhe NJTMH kanë të qartë se ky MB nuk kufizon diskrecionin dhe kompetencat e secilës palë bazuar në legjislacion.

6. Bashkëpunimi në fushën teorike për rritjen e nivelit të Sigurisë.

- 6.1 Secila palë pranon rolin e rëndësishëm të palës tjetër në lidhje me interesin publik dhe nevojën e kryerjes së detyrës sa më mirë dhe brenda një kohe sa më të shkurter, bazuar në detyrimet e tyre ligjore, duke punuar për njohjen së bashku të Kodit Ajror të RSh dhe Rregulloreve të BE, për Aviacionin Civil.



- 6.2 Palët sigurojnë pjesëmarrje në takime dhe analiza të organizuara prej tyre për problemet e Sigurisë së Fluturimeve.
- 6.3 Palët marrin përsipër të organizojnë takime e konsultime për probleme të veçanta në rang specialist`sh dhe ekspertësh.

7. Rolet dhe Detyrat e përbashkëta.

- 7.1 NJTMH ka detyrim ligjor të njoftojë sa më shpejt të jetë e mundur OKIIA për çdo rast incidenti/aksidenti të një HeL.
- 7.2 NJTMH merr përsipër të kryejë fluturime familjarizuese me anet`arët e OKIIA.
- 7.3 NJTMH i jep IND të dhëna për: identifikimin e zonës së ndodhjes të ngjarjes, tipin e HeL, numrin e fluturimit, shenjën e thirrjes, origjina dhe destinacioni i fluturimit.
- 7.4 NJTMH nuk duhet të japë informacion për media pa u konsultuar më parë me IND.

8. Parimet bazë të MB

- 8.1 Palët sigurojnë që do të ndërmarrin hapa të ndjeshëm që Inspektorët e OKIIA dhe Personeli i NJTMH në përvetësimin dhe familjarizimin me përmbajtjen dhe kërkesat e këtij MB.
- 8.2 Palët mund t`a ndryshojnë këtë MB në çdo moment duke rënë dakort midis tyre. Çdo ndryshim duhet të bëhet me shkrim dhe do të jetë një shtojcë e këtij MB i cili hyn në fuqi në datën që bihet dakort në materialin shtojcë.
- 8.3 Ky MB hyn në fuqi menjëherë në datën që nënshkruhet nga të dy palët, dhe ka vlefshmëri 2 (dy) vjet. Në mbarim të këtij afati, riaprovohet një afat i ri vlefshmërie me anë të një njoftimi me shkrim.
- 8.4 Secila palë në çdo moment mund të shprehë me njoftim me shkrim qëllimin e saj për rinovimin/ndërprerjen e këtij MB. Njoftimi për përfundimin e këtij MB duhet të bëhet jo më vonë se 3 (tre) muaj nga data që propozohet për ndërprerjen e MB.

9. Kontaktet per zbatimin e MB.

OKIIA	NJTMH
P.O.Box74 Tiranë, Shqipëri e-mail: info@okiia.gov.al	Fusha e Aviacionit Laprake Tirane. tel: ++355 42247898 fax: ++355422278175 e-mail: njesiahelikopter@yahoo.com e-mail: a_xhafaj@yahoo.com

Dipl.Ing. Arben XHIKU
Drejtor i Përgjithshëm



Cpt. Albert XHAFA
Shëfi i NJTMH

